



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, nenit 2 paragrafi 7 i Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 17.04.2020, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIM E KLUBEVE SPORTIVE

Neni 1.

NDAHET, shuma e mjeteve e mjeteve financiare ne vlerë prej 34,735.00 (tridhjetë katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë euro) euro për subvencionimin e klubeve sportive të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

1.Shuma e mjeteve do të cekura do të ndahet nga kategoria ekonomike subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.

2.Klubet sportive do të subvencionohen në shumën 50% të shumës së subvencionimit të secilit klub në raport me vitin 2019 i cili ka qenë në total 69.470 euro për të gjitha klubet sportive.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15Nr. 400-16852

Lipjan, më 17.04.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

